

Shefja suedeze e diplomacisë, Margot Wallstrom, njoftoi sot se qeveria e saj njeh nëpërmjet një dekreti shtetin e Palestinës, duke u bërë vendi i parë perëndimor i BE-së, që merr një vendim të tillë.

“Sot qeveria merr vendimin për të njohur shtetin e Palestinës. Është një hap i rëndësishëm, që konfirmon të drejtën e palestinezëve për vetëvendosje”, njoftoi ministrja e Punëve të Jashtme në një shkrim të publikuar në të përditshmen “Dagens Nyheter”.

“Qeveria konsideron se kriteret e së drejtës ndërkombëtare për një njohje të shtetit palestinez janë përmbushur. Një territor me kufij fiks, një popullsi dhe një qeveri”, shtoi ajo.

“Ne shpresojmë se kjo do të hapë rrugën edhe për të tjerët”, theksoi Wallstrom.

Deri tani, të paktën 112 shtete kanë njohur shtetin e Palestinës.

Sipas autoriteteve palestineze, duhet të jenë 134 shtete, ku shtatë janë anëtarë të Bashkimit Evropian që e kanë njohur para se të bëheshin pjesë e BE-së, këto janë Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Bullgaria, Rumania, Malta dhe Qiproja e Jugut.

Gjatë deklaratës mbi politikën në përgjithësi të qeverisë suedeze në fillim të tetorit, Kryeministri Stefan Lofven kishte njoftuar se Suedia do të njohë shtetin e Palestinës dhe kjo ishte përshëndetur nga autoritetet palestineze, por ishte kritikuar nga Izraeli dhe SHBA-të.